

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Evelina QIRJAKO	Kryesues
Ardian DVORANI	Anëtar
Medi BICI	Anëtar

në datën 22.02.2017, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 03446/2014, që u përket palëve:

PADITËS: Riza Keçi
PALË E PADITUR: Komuna Velipojë
OBJEKTI: *Anullimin e vendimit nr. 190, datë 23.11.2011 të Kryetarit të Komunës Velipojë dhe kthimin në detyrën e mëparshme. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë dëmshpërblim në masën e dy pagave mujore për arsye të mosrespektimit të afatit të njoftimit. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë dëmshpërblim në masën e dy muajve pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë dëmshpërblim në masën e pagës së 12 muajve për arsye të zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë shpërblim për vjetërsi në punë në masën e pagës së dy muajve. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë shpërblim për pushimet vjetore për vitin 2011.*

BAZA LIGJORE: *Nenet 12, 21, 92, 93, 94, 140, 145, 146 dhe 155 të Kodit të Punës; neni 115 të K.Pr.Administrative.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1292 (4357), datë 15.05.2012, ka vendosur:

-Pranimin e pjeshëm të kërkesë-padisë.

- Detyrimin e palës së paditur Komuna Velipojë që t'i paguajë paditësit Riza Keçi pagën deri në përfundim të afatit të njoftimit, nga data 30.11.2011 – 31.01.2012.
- Detyrimin e palës së paditur Komuna Velipojë që t'i paguajë paditësit Riza Keçi një dëmshpërblim në masën e 10 (dhjetë) muajve pagë për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës.
- Detyrimin e palës së paditur Komuna Velipojë që t'i paguajë paditësit Riza Keçi një dëmshpërblim në masën e 2 (dy) muajve pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.
- Detyrimin e palës së paditur Komuna Velipojë që t'i paguajë paditësit Riza Keçi një shpërblim për vjetërsi në punë në masën e 1 (një) muaji e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pagë.
- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 388, datë 28.01.2014, ka vendosur:

-Moskompetencën për gjykimin çështjes civile nr. regjistri 394/1054/1561, regjistrimi 08.06.2012 dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 551, datë 10.03.2014, ka vendosur:

-Ndryshimin e vendimit nr. 1292 (4357), datë 15.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në këtë mënyrë:

-Pranimin e pjeshëm të padisë.

- Detyrimin e palës së paditur Komuna Velipojë që t'i paguajë paditësit Riza Keçi një dëmshpërblim në masën e 2 (dy) muajve pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 551, datë 10.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1292 (4357), datë 15.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Tiranë më 22.02.2016

Nr. 31003-03446-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-587 i Vendimit (70)